



An Garda Síochána ka kënaqësinë të publikojë *Raportimin Online për Krimin e Urrejtjes*, i cili mund të qaset në www.garda.ie.

Nëse jeni viktimë ose dëshmitar i një incidenti që kërkon vëmendjen e menjëhershme të Policisë - telefononi menjëherë 999 ose 112.

Çfarë nënkuptojmë me Krim të Urrejtjes?

Bazuar në përkufizimin e An Garda Síochána për [Krimin e Urrejtjes](#) - ju mund të jeni viktimë e një Krimi të Urrejtjes nëse i jeni nënshtruar një veprë penale si Sulmi, Ngacmimi ose Prishja e Rendit Publik dhe besoni se keni qenë në shënjestër për shkak të moshës tuaj të perceptuar, paaftësisë, racës, ngjyrës, kombësisë, përkatësisë etnike, fesë, orientimit seksual ose gjinisë. Këto quhen karakteristika të mbrojtura.

Çfarë nënkuptojmë me Incidente të Urrejtjes?

Jo të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me Urrejtjen do të përbëjnë një vepër penale. Ne i quajmë këto Incidente të Urrejtjes Jo-kriminale. Incidentet e Urrejtjes Jo-Kriminale mund të përfshijnë dukuri të nivelit të ulët të Diskriminimit, Bullizmit, Abuzimit në Internet ose Abuzimit Verbal. Është po aq e rëndësishme që t'i raportoni edhe tek ne Incidentet e Urrejtjes Jo-Kriminale.

Çfarë ndodh nëse nuk kam prova mbështetëse?

Mos u shqetësoni. Nuk keni nevojë të keni prova mbështetëse për të bërë një raport tek ne dhe duke e bërë këtë, ju nuk po angazhoheni për të ndërmarrë ndonjë veprim të mëtejshëm.

- Ne do të dëgjojmë se çfarë keni për të thënë
- Do të bëjmë një regjistrim të incidentit
- Do të diskutojmë opsionet e disponueshme me ju dhe do të biem dakord për mënyrën më të mirë për të vazhduar

Pse të Raportojmë Urrejtjen?

Raportimi i një Krimi të Urrejtjes ose Incidenti të Urrejtjes do të na ndihmojë të kuptojmë se çfarë ju ka ndodhur dhe çfarë përgjigje ju nevojitet. Do të na lejojë gjithashtu të shohim se ku ndodhin këto lloj incidentesh dhe sa shpesh. Kjo do të na ndihmojë t'i mbajmë njerëzit të sigurt duke siguruar një përgjigje më të mirë nga ana e policisë.

Bëjeni të Dukshëm Krimin e Urrejtjes - Raportojeni atë Sot #LetsStopHateTogether

An Garda Síochána

